

**LETËR PUBLIKE ZOTIT JEANS –LUOIS LAURENS, DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
PËR DEMOKRACINË DHE ÇËSHTJET POLITIKE NË KËSHILLIN E EUROPËS,**

I nderuar zoti Jean –Louis Laurens: Duke shprehur respekt për personin tuaj si diplomat me përvojë dhe njohës i vuajtjeve të popullit shqiptar, që nga koha e diktaturës si dhe për institucionin që përfaqësoni si Drejtor i Përgjithshëm për Demokracinë dhe Çështjet Politike në Këshillin Europës, më lejoni të shpreh opinionin themelor që ka munguar në intervistën tuaj të datës 15 Dhjetor 2010. Ju shpreheni qartë opinionin tuaj kundër islamofobisë, theksoni rëndësinë e Sistemit të Drejtësisë dhe shkollës së magistraturës . Ne ndiejmë se së pari duhet të vendoset drejtësia në sistemin e drejtësisë në mënyrë që projektet për shkollën e magistraturës të japin rezultate pozitive. Ju theksoni se “...dështimi kryesor në Shqipëri janë zgjedhjet elektorale. Sa herë ka zgjedhje ato kthehen në një dramë kombëtare. Nërkohe që duhet të jenë pjesë normale e ndërtimit të institucioneve....” Kjo janë vetëm një pjesë e realitetit dhe rrjedhoja që nuk mund të përmirësohen madje do përkeqësohen edhe më tej. Pjesa thelbësore që ju keni anashkaluar në intervistën tuaj është shkelja konstante e të drejtës që qytetarëve për të gëzuar pronën e tyre të trashëguar që ju është shtetëzuar me ligjet e komunizmit pas vendosjes së diktaturës në 1945. Në vitin 1991 u shemb monizmi, u vendos pluralizmi politik, u lejua feja dhe liria e fjalës, u futën disa elemente të çregullt të ekonomisë së tregut, dhe tani në Dhjetor 2010 populli fitoi të drejtën e lëvizjes së lirë në zonën Schengen.Këto janë arritje por demokracia akoma nuk është vendosur. Prej 1991 e deri sot u kultivua korrupsioni që sot ka pushtuar të gjithë administratën tonë shtetërore. Në këto 20 vjet tranzicion anarkik dhe kleptokratik, të gjitha qeveritë që kanë zëvendësuar njëra tjetrën kanë miratuar ligje që shkelin detyrimet kushtetuese dhe pengojnë kthimin fizik të pronës tek i zoti duke bërë të mundur përvetësimin e pronës nga pushtetarët. Në diskutimet e datës 16 Shtator 2010 në Kuvendin e Shqipërisë ndërmjet të tjerash deputetët kanë deklaruar se duhen bërë ligji : “.....që e kthen pronën tek i zoti dhe jo tek horri i rradhës ...” se “...Pronarët kanë ngelur përballë padrejtësisë dhe pamundësisë; padrejtësisë që është krijuar gjatë këtyre viteve me ligj, të cilat kanë cenuar të drejtën e pronës së tyre dhe pamundësisë për të marrë pronën që i takon”. ....” E paligjshmja është bërë

e ligjshme kundër çdo standardi kushtetues dhe evropian. Ndërsa e ligjshmja, e drejta nuk kanë as forcën dhe as mbështetjen për të gjetur zgjidhjen e duhur” Edhe Kryeministri Zoti Sali Berisha që është përgjegjës për këtë situatë ndër të tjera deklaroi : “...një përballje midis mafies grabitqare të tokave në këtë vend dhe pronarëve të mjerë, të cilët gjatë këtyre viteve panë tentakulat e pushtetit të shtrihen drejt tokve të tyre drejt pronave të tyre”. ... “Një amalgamë pushtetarësh grabitqarë me pseudopronarë, që kanë grabitur dhe vëllezërit e tyre , me fallsifikime monstruoze e me ndihmën e pushtetarëve kanë lënë duar bosh pronarët e vërtetë“ ..... “Beteja për pronën është beteja për sistemin. Beteja për stabilizimin e pronës është beteja për stabilizimin e kapitalizmit në Shqipëri. Absolutisht.” Praktikisht Shqipëria si asnjë nga vendet e ish kampit socialist, ka instaluar një sistem kleptokratik që pranohet nga të gjithë përfshi edhe Kryeministrin. Vjedhja e pronave është realiteti i Shqipërisë, këtu është plaga që duhet shëruar, në të kundërt, lufta politike midis dy krahëve të politikës që është krejt e pa konceptushme për ju dhe po ashtu .zgjidhjet do vazhdojnë të jenë ashtu sic i keni përcaktuar ju zoti Jean –Louis Laurens. Politikanët shqiptarë të pas vitit 1991 pronën që para 1945 i përkiste shtetit dhe pronën e shtetëzuar nga diktatura duke shkelur detyrimet kushtetuese e përvetësuan për familjet e tyre dhe e shpërndanë për klanet dhe interesat elektorale. Kjo është shkaku pse zgjedhjet në Shqipëri kurrë nuk mund të respektojnë standardet europiane sepse edhe vetë sistemi nuk është demokratik dhe kjo është një dramë e vërtetë për popullin dhe kombin shqiptar. Faj për këtë kanë dhe organizmat monitoruese dhe institucionet e KE, BE dhe OSBE, pasi ato janë në dijeni të ligjeve që grabisin pronën por në instancat e larta të KE dhe BE, problemi i pronës relatohet ashtu siç ju intereson politikanëve të pangopur grabitqarë. Zgjidhja sot është e thjeshtë por ajo mund të bëhet vetëm nga institucionet e KE dhe BE. Kjo zgjidhje realizohet shpejt dhe mirë nëse Institucionet ndërkombëtare, do të ushtrojnë presion kushtëzues, duke përcaktuar edhe afat kohor për implementimin e një ligji që të përputhet me Konventën Europioane të të Drejtave të Njeriut, me kërkesat e nenit 191 të dok. Nr 11115 dt 20 Dhjetor 2006 të Asamblesë Parlamentare të KE për Shqipërinë dhe me kërkesat e nenit 181 dhe 41 të Kushtetutës. Ky ligj duhet të përcaktojë shpalljen e pa vlefshmërisë për aktet me të cilat shteti pas vitit 1991 ka transferuar në persona të

tretë pronat për të cilat shteti nuk kishte titull pronësie. Vec kësaj ligji duhet të përcaktojë detyrimin e shtetit për të bërë kthimin fizik të pronës duke respektuar titujt e pronësisë në përputhje me detyrimet kushtetuese.

Nga Rrapo Hajredin Danushi

Kryetar i Shoqatës Kombëtare të të Shpronësuarve

“Pronësi me Drejtësi”